



103

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 18413 prot.

Vlorë, më 18.11.2025

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ datë _____.2025

PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË GRANTIT TË MENJËHERSHËM NGA BUXHETI I SHTETIT FAMILJEVE QË KANË PËRFITUAR STREHIM NË BANESAT E NDËRTUARA NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 24 pika 1, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” neni 45 dhe 46, të VKM Nr.555 datë 15.07.2020 “Për procedurat dhe përparësitë për akordimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët nga buxheti i shtetit”, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.43, datë 28.09.2006 “Ndarje e banesës tip 83/7 (1) tek ish-frigoriferi për të pastrehët nga firmat piramidale”, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.11, datë 16.04.2008 “Ndarje apartamentesh tip 83/7 (2) të ndërtuar nga Enti Kombëtar i Banesave për të pastrehët”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë,

VENDOSI

- I. Të miratojë dhënien e grantit të menjëhershëm nga buxheti i shtetit familjeve të trajtuara me strehim në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave si vijon :
 1. Familjes së znj. Lutfije Mustafaraj e trajtuar me Banesë me Kosto të Ulët me Vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.43, datë 28.09.2006, në masën 10% e çmimit të shitjes së banesës, 10% e 2 444 620 =244 462 lekë.
 2. Familjes së znj. Liri Memet Jupe e trajtuar me Banesë me Kosto të Ulët me Vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.11, datë 16.04.2008, në masën 10% e çmimit të shitjes së banesës, 10% e 2 237 691 =223 769 lekë.
- II. Të miratojë kërkesën drejtuar ministrisë përgjegjëse për çështjet e strehimit, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, për akordimin e grantit të menjëhershëm ndaj familjeve të znj.Lutfije Mustafaraj dhe znj. Liri Jupe në vlerat e përcaktuara më sipër.
- III. Efektet financiare sipas pikës 1 dhe 2 do të mbulohen nga buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit në fondet për programet e strehimit social të vitit 2026.

- IV. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës & Investimeve Publike dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

KRYETAR

Elis Halili





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 18413 prot.

Vlorë, më 19.11.2025

RELACION

Mbi projekt-vendimin

PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË GRANTIT TË MENJËHERSHËM NGA BUXHETI I SHETIT
FAMILJEVE QË KANË PËRFITUAR STREHIM NË BANESAT E NDËRTUARA NGA ENTI
KOMBËTAR I BANESAVE

Pranë Bashkisë Vlorë kanë depozituar kërkesat për të përfitur Grantin e Menjëhershëm nga Programet e Strehimit Social, 6 familje, të cilat janë trajtuar me strehim në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave në vitet, 2006, 2008 dhe 2024, si vijon:

1. Lutfije Mustafaraj ka përfitur apartament (1+1) në banesën tip 83/7 (1) tek ish-frigoriferi për të pastrehët nga firmat piramidale, miratuar me VKB Nr.43, datë 28.09.2006
2. Liri Jupe ka përfitur apartament (1+1) në banesën tip 83/7 (2) tek ish-frigoriferi për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, miratuar me VKB Nr. 11, datë 16.04.2008.
3. Vjollca Serjanaj ka përfitur apartament (1+1) në banesat tip 83/7 (2) tek ish-frigoriferi për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, miratuar me VKB Nr. 11, datë 16.04.2008.
4. Lefteri Kamberaj ka përfitur apartament garsonierë në banesat tip 83/7 (1) tek ish-frigoriferi për të pastrehët nga firmat piramidale, miratuar me VKB Nr.43, datë 28.09.2006
5. Natasha Lamaj ka përfitur apartament (2+1) në banesat me kosto të ulët, miratuar me VKB Nr.6, datë 29.01.2024
6. Sanije Malaj ka përfitur apartament (2+1) në banesat me kosto të ulët, miratuar me VKB Nr.6, datë 29.01.2024

Në zbatim të ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar dhe të VKM Nr.555, datë 15.07.2020 “Për procedurat dhe përparësitë për akordimin e grantit të menjëhershëm për banesa me kosto të ulët nga buxheti i shtetit” përfitojnë grant të menjëhershëm me përparësi:

1. Kryefamiljarët me aftësi të kufizuara
2. Familjet me më shumë se një person me aftësi të kufizuara
3. Individët me statusin e jetimit, që jetojnë në banesa të papërshtatshme, ose konvikt
4. Kryefamiljarët e vetëm, viktimë e dhunës në familje
5. Familjet njëprindërore të minoritetit rom dhe egjiptian

6. Familjet e punonjësve të rendit të rënë në detyrë, që përfitojnë kredi me interes 0%
7. Fëmijët në përkujdesje të Republikës sipas legjislacionit në fuqi
8. Familjet/individët që kanë në përbërje:
 - Një person me aftësi të kufizuara
 - Një individ me statusin e jetimit, i cili në momentin e aplikimit nuk ka mbushur moshën 30 vjeç
 - Kryefamiljari i vetëm, në rastin kur ka në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç
 - Familjet e minoritetit rom dhe egjiptian,

të cilët kanë rënë në vështirësi financiare dhe rrezikojnë të humbasin banesën me kosto të ulët që kanë blerë me kushte kreditimi

***Shuma e grantit të menjëhershëm, që përfiton individi/familja është në masën 10% të çmimit të shitjes së banesës me kosto të ulët, përveç rasteve të përcaktuara në pikat 6 dhe 7, për të cilët shuma e grantit është 20% e çmimit të shitjes së banesës me kosto të ulët.**

Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë i mbledhur në datën 14.11.2025 mori në shqyrtim kërkesat dhe dokumentacionin e paraqitur nga 6 familjet që përmban:

1. Kopje të kontratës së shitblerjes së banesës me kosto të ulët, të lidhur me Entin Kombëtar të Banesave
2. Dokumentin e lëshuar nga Enti Kombëtar i Banesave, që nuk kanë përfituar zbritje të vlerës së banesës për shkak të statusit të familjes.
3. Çdo dokument tjetër të përcaktuar me VKM Nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”.
Nga vlerësimi i të gjitha kërkesave dhe i dokumentacionit, krahasimisht me përcaktimet në aktet ligjore e nënligjore për të përfituar Grantin e Menjëhershëm, Komisioni vendosi të miratojë dhënien e Grantit të Menjëhershëm për dy familjet; Lutfije Mustafaraj dhe Liri Jupe.
4. Lutfije Mustafaraj, e moshuar e vetmuar, me statusin invalid paraplegji +tetraplegji, me të ardhura 20038 lekë në muaj pension pleqërie dhe 12993 ndihmë ekonomike paraplegjie. Ka lidhur kontratën e shitjes me këste me EKB, Dega Rajonale Vlorë për apartamentin e përfituar në vlerën 2 444 620 lekë me interes 2% në vit, për 25 vjet, me këst mujor 10 715 lekë. Përfiton grantin e menjëhershëm në masën 10% të çmimit të shitjes së banesës, 10% e 2 444 620 =244462 lekë.
5. Liri Jupe, është kryefamiljare me aftësi të kufizuara që trajtohet me pension invaliditeti në shumën 23875 lekë në muaj. Ka lidhur kontratën e shitjes me këste me EKB, Dega Rajonale Vlorë për apartamentin e përfituar në vlerën 2 237 691 lekë për 25 vjet, me këst mujor 9500 lekë. Përfiton grantin e menjëhershëm në masën 10% të çmimit të shitjes së banesës, 10% e 2 237 691 =223769 lekë.

6. Në këtë fazë, 4 familjet e tjera nuk bëjnë pjesë në kategoritë që trajtohen me përparësi. Duke qenë se Granti i Menjëhershëm përfitohet vetëm një herë nga familjet në të gjithë periudhën e shlyerjes së vlerës së banesës, ato mund të apalikojnë në një fazë tjetër, nëse do të përfshihen në ato kategori prioritare.

Sa më lart komisioni konkludoi që, nëpërmjet projektvendimit që do të përgatitet nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, ti kërkojë Këshillit të Bashkisë të miratojë dhënien e Grantit të Menjëhershëm për familjet e Lutfije Mustafarj dhe Liri Jupe. Nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Bashkisë të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për strehimin kërkesën për akordimin e Grantit të Menjëhershëm nga buxheti i shtetit për vitin 2026 për këto familje në masën 10% të çmimit të shitjes së apartamentit e përcaktuar sa më sipër.

Drejtore i DI&IP
Dorjana Ferati



Specialiste e Strehimit
Drita Mustafai





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KOMISIONI I STREHIMIT**

Nr. 19414 prot.

Vlorë, më 19.11.2025

MIRATOHET

KRYETAR

Elis Halili

VENDIM

Nr. 12 datë 14. 11. 2025

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE DHE PËRZGJEDHJEN E FAMILJEVE QË
PËRFITOJNË GRANTIN E MENJËHERSHËM NGA BUXHETI I SHTETIT PËR
VITIN 2026.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 24 pika 1, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” neni 45 dhe 46, të VKM Nr.555 datë 15.07.2020 “Për procedurat dhe përparësitë për akordimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët nga buxheti i shtetit”, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.43, datë 28.09.2006 “Ndarje e banesës tip 83/7 (1) tek ish-frigoriferi për të pastrehët nga firmat piramidale”, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.11, datë 16.04.2008 “Ndarje apartamentesh tip 83/7 (2) të ndërtuar nga Enti Kombëtar i Banesave për të pastrehët”, Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë, i mbledhur në datën 14.11.2025 mori në shqyrtim të gjitha aplikimet e depozituara pranë Bashkisë Vlorë nga familjet që kanë përfutur strehim në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave në vitet 2006, 2008 dhe 2024, për të përfutur nga programet sociale të strehimit, instrumentin financiar të Grantit të Menjëhershëm.

KONSTATOI

Pranë Bashkisë Vlorë kanë depozituar kërkesat për të përfutur Grantin e Menjëhershëm nga Programet e Strehimit Social 6 familje, të cilat janë trajtuar me strehim në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave në vitet, 2006, 2008 dhe 2024, si vijon:

1. Lutfije Mustafaraj ka përfutur apartament (1+1) në banesën tip 83/7 (1) tek ish-frigoriferi për të pastrehët nga firmat piramidale, miratuar me VKB Nr.43, datë 28.09.2006
2. Liri Jupe ka përfutur apartament (1+1) në banesën tip 83/7 (2) tek ish-frigoriferi për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, miratuar me VKB Nr. 11, datë 16.04.2008.

3. Vjollca Serjanaj ka përfituar apartament (1+1) në banesat tip 83/7 (2) tek ish-frigoriferi për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, miratuar me VKB Nr. 11, datë 16.04.2008.
4. Lefteri Kamberaj ka përfituar apartament garsonierë në banesat tip 83/7 (1) tek ish-frigoriferi për të pastrehët nga firmat piramidale, miratuar me VKB Nr.43, datë 28.09.2006
5. Natasha Lamaj ka përfituar apartament (2+1) në banesat me kosto të ulët, miratuar me VKB Nr.6, datë 29.01.2024
6. Sanije Malaj ka përfituar apartament (2+1) në banesat me kosto të ulët, miratuar me VKB Nr.6, datë 29.01.2024.

Bashkë me kërkesat këto familje kanë paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore :

1. Kopje të kontratës së shitblerjes së banesës me kosto të ulët, të lidhur me Entin Kombëtar të Banesave
2. Dokumentin e lëshuar nga Enti Kombëtar i Banesave, që nuk kanë përfituar zbritje të vlerës së banesës për shkak të statusit të familjes.
3. Çdo dokument tjetër të përcaktuar me VKM Nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”.

Sipas përcaktimeve në aktet ligjore e nënligjore përfitojnë grant të menjëhershëm me përparësi këto kategori:

1. Kryefamiljarët me aftësi të kufizuara
2. Familjet me më shumë se një person me aftësi të kufizuara
3. Individët me statusin e jetimit, që jetojnë në banesa të papërshtatshme, ose konvikte
4. Kryefamiljarët e vetëm, viktimë e dhunës në familje
5. Familjet njëprindërore të minoritetit rom dhe egjiptian
- 6. Familjet e punonjësve të rendit të rënë në detyrë, që përfitojnë kredi me interes 0%**
- 7. Fëmijët në përkujdesje të Republikës sipas legjislacionit në fuqi**
8. Familjet/individët që kanë në përbërje;
 - Një person me aftësi të kufizuara
 - Një individ me statusin e jetimit, i cili në momentin e aplikimit nuk ka mbushur moshën 30 vjeç
 - Kryefamiljari i vetëm , në rastin kur ka në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç
 - Familjet e minoritetit rom dhe egjiptian,

të cilët kanë rënë në vështirësi financiare dhe rrezikojnë të humbasin banesën me kosto të ulët që kanë blerë me kushte kreditimi.

Sa më lart komisioni

VENDOSI

Nga vlerësimi i të gjitha kërkesave dhe i dokumentacionit, krahasimisht me përcaktimet në aktet ligjore e nënligjore për të përfituar Grantin e Menjëhershëm, komisioni vendosi të miratojë dhënien e Grantit të Menjëhershëm për dy familjet, Lutfiye Mustafaraj dhe Liri Jupe.

1. Lutfiye Mustafaraj, e moshuar e vetmuar, me statusin invalid paraplegji +tetraplegji, me të ardhura 20038 lekë në muaj pension pleqërie dhe 12993 ndihmë ekonomike paraplegjie. Ka lidhur kontratën e shitjes me këste me EKB, Dega Rajonale Vlorë për apartamentin e përfituar në vlerën 2 444 620 lekë me interes 2% në vit, për 25 vjet, me këst mujor 10 715 lekë. Përfiton grantin e menjëhershëm në masën 10% të çmimit të shitjes së banesës, 10% e 2 444 620 = 244462 lekë.
2. Liri Jupe, është kryefamiljare me aftësi të kufizuara që trajtohet me pension invaliditeti në shumën 23875 lekë në muaj. Ka lidhur kontratën e shitjes me këste me EKB, Dega Rajonale Vlorë për apartamentin e përfituar në vlerën 2 237 691 lekë për 25 vjet, me këst mujor 9500 lekë. Përfiton grantin e menjëhershëm në masën 10% të çmimit të shitjes së banesës, 10% e 2 237 691 = 223769 lekë.
3. Në këtë fazë, 4 familjet e tjera nuk bëjnë pjesë në kategoritë që trajtohen me përparësi. Duke qenë se Granti i Menjëhershëm përfitohet vetëm një herë nga familjet në të gjithë periudhën e shlyerjes së vlerës së banesës, ato mund të apalikojnë në një fazë tjetër, nëse do të përfshihen në ndonjë prej kategorive prioritare.
4. Familjeve jopërfituese do tu kthehet përgjigje me shkrim mbi arsyet e skualifikimit.
5. Me të gjitha përfundimet e nxjerra nga kjo mbledhje, specialistja e strehimit të përgatisë projekvendimin për miratim në Këshillin e Bashkisë në mbledhjen e muajit nëntor 2025.

KOMISIONI

1. Irena Toshkallari

2. Dorjana Ferati

3. Kristofor Kolagji

4. Skerdilajd Hunda

5. Orest Ruçaj

6. Manuela Prifti

7. Donald Leskaj

8. Bledar Toja

9. Kanan Shakaj

10. Genard Fegaj

11. Selim Haskoçelaj

12. Birçe Aliraj

13. Drita Mustafa